

Thirrje për aplikim për regjistrim në programin e doktoratës në “Shkenca Sociale dhe të Sjelljes”, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2021-2022

Programi i studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “**Shkenca Sociale dhe të Sjelljes**”, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është program i riorganizuar i Doktoratës në “Shkenca Sociale” me Urdhër nr. 111, datë 04/03/2022.

Ky program bazohet mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor.

AFATI I APLIKIMIT 20 PRILL 2022 – 20 MAJ 2022

KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E STUDIMIT

Aplikanti duhet:

- Të ketë fituar diplomën ‘Master i shkencave’ ose ‘Master i Arteve’, apo diplomë të barasvlershme të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente, në fushë të njëjtë ose të përafërt me studimet e doktoratës;
- Të ketë njohje të gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht) në nivelin C1, vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se 2 vjet nga koha e lëshimit të tyre. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- Të ketë notë mesatare të përgjithshme në ciklin më të lartë të studimeve 8 e lart, e llogaritur në bazë të grup-lëndëve karakterizuese të programit të studimit.
- Të jetë personel akademik i Universitetit European të Tiranës, ose personel akademik në një Institucion tjetër të Arsimit të Lartë, ose personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
- Të marrë përsipër përbushjen e standardeve shkencore, akademike, ligjore dhe etike.
- Aplikanti duhet të hartojë një Projekt Propozim bazuar në fushat e detajuara të programit të doktoratës dhe projektit kërkimor të drejtuesit të grupit, preferuar nga ai për udhëheqje.



**Projekti kërkimor - shkencor dhe i zhvillimit
Sjellja e individit dhe aktorëve ekonomik në raport me shtetin dhe shoqërinë.**

| Nënfusha | Drejtimi i Madh kërkimor/ Fushat e detajuara të programit doktoral | Drejtuesit e Grupeve kërkimore | | | | |
|--|---|--------------------------------|------------|---------|---|----------------------|
| | | Grada / Titulli akademik | Emri | Mbiemri | Aksi kërkimor/ Titulli i projektit të grupit kërkimor | Kuota në dispozicion |
| ISCED Code 031 Shkenca sociale dhe të sjelljes | ISCED Code 0312 Shkenca politike dhe edukim qytetar | Prof. Dr. | Kristaq | Xharo | Siguri dhe mbrojtje përballë sfidave bashkëkohore rajonale dhe më gjerë. | 3 |
| | | Prof. Dr. | Tonin | Gjuraj | Raportet shtet – shoqëri në Shqipërinë e tranzicionit. | 3 |
| | | Prof. Asoc.Dr. | Enri | Hide | Impakti gjeopolitik rajonal i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar. | 2 |
| | | Prof. Asoc.Dr. | Ervis | Iljazaj | Raporti midis Përfaqësimit, Partive Politike dhe Institucioneve. | 2 |
| | ISCED Code 0313 Psikologji | Prof. Asoc.Dr. | Voltisa | Lama | Shëndeti mendor i fëmijëve. | 2 |
| | ISCED Code 0314 Sociologji dhe studime kulturore | Prof. Dr. | Fatos | Tarifa | Dinamika e modernizimit të shoqërisë shqiptare si morfologji politike dhe gramatikë morale. | 3 |
| | | Prof. Dr. | Aleksander | Dhima | Antropologjia fizike shqiptare dhe impakti në shëndetin publik. | 3 |

DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM

Aplikantët duhet të dorëzojnë pranë Koordinatorës së zyrës Doktorale, dosjen me dokumentacionin e kërkuar duke filluar nga data **20.04.2022** deri në datë **20.05.2022**.

Dosja duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë personale drejtuar Departamentit të Shkencave të aplikuara, pranë **Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare**, përgjegjës për organizimin dhe administrimin e studimeve të ciklit të tretë;
2. CV personale dhe nje listë e punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së aplikimit (në rastin kur personi që aplikon ka të tilla);
3. Kopje të noterizuara të diplomës universitare, kopje të noterizuar të diplomës “Master i shkencave” (ose të një diplomë ekuivalente me të si “DND”), si dhe kopje të noterizuar të listës së notave për të gjitha nivelet e studimeve/diplomave.
4. Fotokopje e ID ose pasaportës;
5. Dy fotografi;
6. Dy rekomandime nga persona me titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”;
7. Një propozim kërkimi në të cilin përcaktohet dhe emri i udhëheqësit shkencor (template bashkëlidhur) ;
8. Kandidati duhet të dorëzojë dëshmi origjinale ose të noterizuar të njohjes së gjuhës së huaj.

Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentet e sipërpërmendura nuk merren në konsideratë.